

**VENDIM**  
**Nr.358, datë 10.9.1997**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.694, DATË 21.10.1996 “PËR NORMËN MËSIMORE-SHKENCORE NË SHKOLLAT E LARTA DHE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, PAGIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE, AKTIVIZIMIN E PENSIONISTËVE DHE PUNONJËSVE TË JASHTËM NË SISTEMIN E ARSIMIT”**

Mbështetur në ligjin nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 27, në ligjin 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, neni 53, dhe me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.694, datë 29.10.1996, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 shfuqizohet

2. Në pikën 2 shtohet ky paragraf:

“Për rastet e jashtëzakonshme, me vendim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, shkollat e larta mund të aktivizojnë punonjës të jashtëm, që të lejohen të japin orë mësimore mbi normën e mësipërme”.

3.Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Sasia e orëve mësimore mbi normën e miratuar lejohet sipas nevojave të shkollës, por jo më shumë se 30% e normës.” Ky paragraf i shtrin efektet për vitin mësimor 1997-1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Fatos Nano**